

---

## ***Mother Teresa: Saint or Celebrity?***

By Gëzim Alpion

Routledge: London and New York, 2007, xx, pb & hb, 284 pp

ISBN 10: 0-415-39246-2 (hbk)

ISBN 10: 0-415-39247-0 (pbk)

ISBN 10: 0-203-08751-8 (ebk)

ISBN 13: 978-0-415-39246-4 (hbk)

ISBN 13: 978-0-415-39247-1 (pbk)

ISBN 13: 978-0-203-08751-0 (ebk)

Paperback: List Price £16.99; \$26.95

Hardback: List Price £65.99; \$110.00

Simultaneously published in the UK, the USA and Canada

---

## ***Gazeta Rimëkëmbja***

Tirana, Albania

28 November 2006, pp. 1, 3

### **Edhe një libër për Nënë Terezën: ‘Shenjtore apo Famëtore’**

#### **By Abdi Baleta**

Ashtu siç ishte njoftuar në muajin tetor në Britaninë e Madhe u vu në qarkullim libri *Mother Teresa, Saint or Celebrity?* (Nënë Tereza: Shenjtore apo Famëtore?), shkruar nga një intelektual tashmë i njohur shqiptar, Gëzim Alpion, i cili prej vitesh jeton dhe punon në Angli dhe ligjëron në Universitetin e Birmingamit. Alpion është autor i një sërë librash me subjekte të ndryshme.

Qysh kur u njoftua paraprakisht se Gëzim Alpion po e përgatiste një libër kushtuar figurës së Nënë Terezës tërhoqi vëmendjen titulli i paralajmëruar i librit në formën e një pyetje që shumë njerëz nuk do të kishin qejf të bëhej, sepse parapëlqejnë që për Nënë Terezën të flitet e të shkruhet vetëm nga këndvështrimi i ‘Shenjtërisë’. Madje këtë qëndrim e mbajnë jo vetëm individë besimtarë katolikë, kleri e institucionet e kishës katolike, por edhe parti politike, si Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Kryetari ri i kësaj partie, Nard Ndoka, që sapo ka braktisur reformatoret pollarë, më 19 nëntor 2006 ka propozuar që në qytetin e Shkodrës të ngrihet një 'Shtëpi-muze për Nënë Terezën'. Këtë ai e ka shpallur si 'një nga përparësitë kulturore të PDK-së' (*Koha Jonë*, 20 Nëntor 2006). Për t'i dhënë forcë bindëse propozimit të tij Ndoka ka përdorur një argument shumë 'origjinal' (si gjithë paraqitjet e tij të shpeshta në ekranet televizive): 'Ne duhet të ndërtojmë një shtëpi muze, e cila shumë shpejt do të bëhej qendër pelegrinazhi për miliona turistë nga e gjithë bota'. Pas 'turizmit kulturor' që e propagandon shumë ministri i kulturës dhe i turizmit, Bujar Leskaj, tani po na reklamohet dhe një 'turizëm fetar nënëterezist', një 'turizëm pelegrinësh' që do të sjellka në Shqipëri miliona turistë e miliarda dollarë. Me të tillë 'turizma' ka të ngjarë që ai turizmi normal për diell e për det, për mal e fushë, më i përshtatshëm për Shqipërinë, të mbetet në nivelet që është. Ka më shumë mundësi që 'turizmi nënëterezist' që do të organizojë Ndoka me demokristianët të mbetet një 'turizëm varfanjak', 'turizëm për sevap', sepse Nënë Tereza është idhulli i të varfërve, jo i pasanikëve.

Nard Ndoka e di se në Shkodër nuk ekziston ndonjë shtëpi që të ketë lidhje me jetën ose me veprimtarinë e Nënë Terezës dhe të mundësojnë shpallejn e saj Muze, si për shembull shtëpia ku ka jetuar Gëte në Vajmar, Pushkini në Moskë, Tolstoi në Jasnaja Paljana, Nënë Tereza në Kalkuta të Indisë e të tjerë njerëz që kanë marrë emër të madh në botë, apo ku u lindën dhe u rritën Enveri e Kadareja në Gjirokastrë ose Luigj Gurakuqi në Shkodër etj. Shtëpitë-muze duhet të kenë ekzistuar para se njeriu që ka një lidhje me to të ketë hyrë në rrethin e famnorëve. Ka kuptim të bëhet 'Shtëpi-muze e Nënë Terezës' një shtëpi ku ajo ka lindur, ose ka kaluar një pjesë të jetës. Por kjo shtëpi mund të jetë e duhet kërkuar në Shkup, jo në Shkodër.

Ndoka (ose ai që ia ka sugjeruar propozimin Ndokës) e di këtë rregull prandaj thotë: 'ndërsa ne që kemi këtu varret e prindërve dhe kujtimet e saj, jemi mjaftuar vetëm me përfitimet që vinë prej emrit të shenjtores'. Por edhe Ndoka vetë në emër të demokristianëve atë 'Shtëpinë-muze të Nënë Terezës' e propozon që të nxjerrë përfitime politike. Ai i josh shqiptarët me përfitime turistike, por në mendje ka përfitimet politike për demokristianët.

Për të nderuar kujtimin e përkushtimin fetar katolik të Nënë Terezës shqiptarët e gjithë feve kanë bërë gjithçka duhet, madje në disa drejtime më tepër sesa duhet. Ndoka me sa duket mbas sherreve që krijoi spekulimi nga Ministria e Kulturës për ngritjen e bustit të Nënë Terezës ka dëshirë të nxisë një valë të re sherresh me propozimin që Nënë Terezës t'i ngrihet një shtëpi e re që nuk e ka pasur për ta bërë muze. Për të nderuar Nënë Terezën në përputhje me atë që ka bërë ka plot stenda nëpër muzetë ekzistues në Shqipëri. Apo dikush ka menduar që për revansh ndaj 'Muzeut të ateizmit' që diktatura komuniste ngrihi dikur në Shkodër të ndërtohet një 'Muze i katolicizmit'?! Shqipëria nuk duhet të hyjë në këtë rrugë, të ngritjes së 'muzeve fetarë'. Apo pas propozimit të Nard Ndokës 'për të ndërtuar shtëpi-muze të Nënë Terezës' në Shkodër qëndron ndonjë projekt-ide që edhe në këtë qytet të ngrihet një 'katedrale me emrin e Nënë Terezës', si ajo e planifikuar në Prishtinë? Nëse është ky synimi i dytë, për ngritjen e një kisha të re të madhe katolike në Shkodër përse të mos shpallet drejtpërsëdrejti? Në Tiranë katedralen e panevojshme katolike e ngritën kur deshën dhe atje ku deshën, në qendër të qytetit dhe askush nuk nxorri pengesa.

Më 20 tetor 2006 *Gazeta Shqiptare* botonte shkrimin e titulluar 'PDK: Nënë Tereza, qeveria indiferente' për të njoftuar se rinia demokristiane qortonte qeverinë se nuk kishte bërë veprimtari (kuptohet politiko-kulturore, sepse qeveria është e ndarë nga kisha), me rastin e përvjetorit të ditës së lumturimit të Nënë Terezës. Pushteti politik e kishte bërë edhe atë që nuk duhej ta bënte, kishte shpallur këtë ditë festë zyrtare dhe ditë pushimi për shqiptarët. Lumturimi i një kandidati për shenjtor të Kishës katolike është veprimtari e mirëfilltë kishtarë dhe nuk i takon një pushteti laik të shpallë ditë festash për nder të shenjtorëve, si në kalendarin kishtar. *Gazeta Shqiptare* (e komanduar nga një italian) njoftonte gjithashtu se PDK kërcënonte të thërriste në interpelancë parlamentare ministrin e kulturës, Bujar Leskajn, për të raportuar se çfarë është bërë për ngritjen e bustit të Nënë Terezës. Kryetari i ri PDK-së, Nard Ndoka, duket ka marrë urdhëra më të prera se paraardhësit e tij të bëjë veprime më të bujshme për teokratizimin katolik të politikës shtetërore shqiptare.

Ja si spekulohet me tepri me emrin e Nënë Terezës. Ja përse duhet reaguar që të frenohen autorët e këtyre spekulimeve të tepruara dhe të këtyre praktikave

sherrnxitëse. Prandaj shpresojmë se libri i Gëzim Alpionit, për të cilin 'çuditërisht' nënëtereizistët dhe shtypi e mediat në Shqipëri kanë mbajtur heshtje, do të sjellë një ndihmesë shumë të vlefshme që opinioni i gjërë të njihet më mirë me jetën e veprën e Nënë Terezës dhe me vlerësimet objektive për të. Titulli i libri nuk i ka shqetësuar dhe përmbajtja e tij me sa duket nuk do t'i zhgënjejë ata që besojnë se autori nuk do të kishte zgjedhur një titull të tillë po të mos kishte ndërmend të bënte një qasje të re nëpërmjet një analize më shumë tokësore ndaj figurës e rolit të Nënë Terezës.

Shkruesi i parathënies së librit, profesori Deivid Marsh, drejtues i Departamentit të Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit, i nis vlerësimet e tij duke theksuar se: 'Nuk ka asnjë dyshim që Nënë Tereza ka qenë dhe është një figurë shumë e njohur nëpërmjet shypit'. Ai përmend se janë botuar 40 libra ku përmbledhen fjalimet e mendimet e saj dhe 519 libra janë shkruar nga të tjerët për të. 'Duke pasur parasysh këtë -vazhdon Marsh- mund të shtrohej pyetja se kujt i duhej edhe një libër më shumë'. Vetë Gëzim Alpion e ka ditur këtë të vërtetë para se të fillonte punën dhe pohon se nuk kishte përse t'i hynte punës për të bërë thjesht një libër tjetër si përsëritje të të parëve. Përkundrazi ai ka synuar të japë një gjë të veçantë, një ndihmesë të tij në ndriçimin e figurës së Nënë Terezës, duke trajtuar pyetjen më delikate se si duhet parë më shumë ajo: si një person që ka fituar emër të madh në botë, apo si një shenjtorë.

Në hyrjen e librit të tij Alpioni ka parashtruar qartë e me ndershmëri shqetësimet e tij lidhur me vështirësitë që do të ndeshte në trajtimin e figurës së Nënë Terezës nga këndvështrimi që kishte zgjedhur ai dhe që e ka zbuluar qysh në titull. Alpion e dinte rregullin se 'nuk mbeten shumë gjëra për t'i rrëfyer publikut për njerëzit që tashmë janë bërë shumë të njohur', për të famshmit që sajohen përditë në media. Prandaj Alpioni pohon se kishte përcaktuar si pikësypnim të librit të tij të nxirrte në pah disa qasje të gabuara dhe përfundime të nxituara lidhur me jetën, personalitetin, punën e trashëgiminë e murgeshës shqiptare.

Alpion nuk ka nguruar ta thotë troç në libër një mendim që ka qarkulluar dhe në botime të mëparshme si një vlerësim irritues për shumëkënd se:

Nënë Tereza dhe puna e saj u bënë të famshme në saje të mediave. Ngjitja e saj në nivelin e njeriut të shquar u gatua dhe u mbikqyr nga ekspertë të marrëdhënieve me publikun dhe nga mjeshtra të suggestionimit në Lindje dhe në Perëndim. Edhe vetë Nënë Tereza në këtë proces për krijimin e famës së saj nuk ka qëndruar pasive. Gjatë 50 viteve që ajo ka rënë në sytë e publikut murgesha e famshme ka luajtur një rol kyç në propagandimin jo aq të vetes sesa të kauzës së saj fetare.

Alpion e thekson se: 'Sado popullore të bëhej Nënë Tereza, ajo nuk mund t'i mbante e vetme nën kontroll mediat'. Nga kërkimet e tij Alpion ka arritur në përfundimin se:

Nënë Tereza bëhej gjithnjë më e vetëdijshme se atë po e përdornin, por dukej se asaj nuk i bëhej vonë për këtë gjë, përderisa popullarizimi i saj në rritje e ndihmonte atë të arrinte qëllimin e jetës së saj, që nuk ishte patjetër t'u shërbente më të varfërve të të varfërve.

Vlerësime të tilla do t'u duken pakëz heretike shumë nënëterezistëve fanatikë që duan të flitet vetëm për shenjtëri kur përmendet emri i Nënë Terezës. Alpion ka qenë i vetëdijshëm edhe për këtë, sepse vetë shkruan:

Nuk janë të shumtë ata njerëz të famshëm që kanë shkaktuar kaq debate të nxehta, kundërshti dhe armiqsi midis ithtarëve të tyre dhe oponentëve të rreptë sa ka shkaktuar Nënë Tereza kur ishte gjallë dhe pas vdekjes. Nuk i duket fundi grindjes së ashpër midis të dy palëve që interesohen për natyrën e saj prej shenjtoreje apo djallëzore.

Vetë Alpion premtan në parathënien se studimi i tij do të qëndrojë larg qasjeve partizane kur thekson: 'Unë as nuk do ta glorifikoj, as ta dënoj Nënë Terezën... Gjëja e vetme që unë kam dashur qysh në fillim ta shmang ishte tundimi për të vështruar Nënë Terezën thjesht si person të shenjtë ose si forcë

djallëzore'. Alpion e njofton lexuesin se për këtë arsye ai vetë është fyer e sulmuar nga njerëz anonimë.

Kur e analizon figurën e Nënë Terezës në kontekst ballkanik autori debaton me njerëz që kanë dashur t'i veshin asaj një rrobë patriotizmi. Në hyrje autori e paralajmëron lexuesin se në kapitullin e katërt të librit janë trajtuar shkencërisht për herë të parë arsyet që mesa duket kishte Nënë Tereza kur nguronte të fliste për familjen dhe kombësinë e saj shqiptare gjatë kohës që ajo dilte në dukje. 'Në fund – thekson autori – unë vlerësoj arsyet pse Vatikani vendosi t'i jepte Nënë Terezës dhe urdhërit të Misionareve të Bamirësisë një trajtim të privilegjuar në fillim të viteve 1960'. Alpion e rithekson se:

Nënë Tereza është ndër të parat midis personaliteteve të njohura fetare në kohët moderne që e kuptoi dhe e përdori me efektivitet të madh pushtetin e medias për të çuar përpara fenë... Kultura e të qenit i famshëm është një formë moderne e fesë.

Në faqen 73 të librit bie në sy një konstatim i tillë nga Alpion:

Lush Gjergji pretendon se refuzimi i Misionareve të Bamirësisë për t'u marrë me shpërndarjen e ilaçeve e paisjeve mjeksore në Kosovë në vitet 1990 "ishte në përputhje me politikën që Nënë Tereza ndoqi gjithë jetën për të mos u trazuar në konflikte politike". Por ka pasur raste kur Nënë Tereza me sa duket nuk merakosej fort për politikën e mospërfshirjes kompromentuese kur ishte fjala për të shpëtuar jetë viktimash të pafajshme, veçanërisht të fëmijëve, në pjesë të tjera të botës. Dihet se ajo dhe murgeshat e saj kanë qenë shumë aktive për të ndihmuar ata që ishin gjendur midis luftimesh në disa konflikte ndërkombëtare ndëretnike, politike, fetare shumë të njohur në Indi, Pakistan, Jordani, Irlandën e Veriut, për të përmendur vetëm disa prej tyre.

Një shpjegim i tillë për 'mospërzierjen e Nënë Terezës' në konfliktin e luftën e Kosovës shton një notë pezmatimi, sidomos kur kemi parasysh sa shumë

përpjekje të sforcuara janë bërë e bëhen për ta fryrë rëndësinë e shenjtërimit të saj për Kosovën. Mbase një konstatim i tillë nga Gëzim Alpion do t'i bëjë të mendojnë më me qetësi dhe me arsye të fortë edhe ata 32 intelektualët shqiptarë që kanë shkruar petitionin e protestës pse po vonohet ndërtimi në Prishtinë i katedrales katolike të parashikuar të mbajë emrin e Nënë Terezës.

Në librin e Gëzim Alpionit mund të ketë edhe vëzhgime e përfundime të tjera pezmatuese. Nënëterezistët e përgjëruar mund të zemërohen. Shumë nga ata që janë mësuar të lexojnë e të dëgjojnë për Nënë Terezën vetëm një propagandë të njëanshme glorifikuese mund të habiten. Por është më mirë që të vërtetat të njihen siç janë, të dëgjojnë e lexohen edhe libra që e trajtojnë në një mënyrë më të veçantë se rryma e përgjithëshme figurën e Nënë Terezës. Libri i Alpionit duhet lexuar me kujdes e vëmendje që të krijohen përshtypjet e vlerësimet sa më reale për ndihmesën që ai sjell në ndriçimin e një figure si Nënë Tereza. Për një libër të tillë mbase më shumë kanë pasur nevojë lexuesit shqiptarë. Dhe është një gjë shumë e mirë për këta lexues që një libër të tillë e marrin nga një intelektual shqiptar që prej vitesh jeton e punon në Perëndim.